



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2026

**PROCES VERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOS NDARJEN E PROCEDURËS
SË PROKURIMIT NË LOTE**

Blerje Autobot uji dhe Automjet lavazho per Ndermarrjen e Pastrimit

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur mbi kufirin e larte monetar ,Mallra

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: Objekti : Blerje Autobot uji dhe Automjet lavazho per Ndermarrjen e Pastrimit

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): CPV):Kodi CPV: 34100000-8 - Automjete

Fondi limit : 20,733,333 (Njeteze million e shtateqind e shtatedhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) Leke pa TVSH

Fondi Limit : 217,171 (dyqind e shtatembedhjetemijë e njeqind e shtatedhjetë e nje) Euro, me kurs kembimi 95.47 sipas Bankes se Shqiperise date 14.05.2026

Duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor sqarojme se:

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin e mosndarjes së procedures në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 parashikohet shprehimisht se: *“Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Në bazë të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar AK nuk është i detyruar ta ndajë në lote por duhet të justifikojë vendimin e vet. Kjo procedurë ndahet në lote për këto arsye:

Objekti : Blerje Autobot uji dhe Automjet lavazho per Ndermarrjen e Pastrimit

Fondi limit : 20,733,333 (Njeteze million e shtateqind e shtatedhjetë e tremije e treqind e tridhjetë e tre) Leke pa TVSH

Fondi Limit : 217,171 (dyqind e shtatembedhjetemije e njeqind e shtatedhjetë e nje) Euro, me kurs kembimi 95.47 sipas Bankes se Shqiperise date 14.05.2026

Kodi CPV: 34100000-8 - Automjete

Tipi i Proçedurës: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra

Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar mundësinë e ndarjes në lote të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje autobot uji dhe automjet lavazho” dhe arrin në përfundimin se mosndarja në lote është e justifikuar për arsye teknike, funksionale dhe administrative.

Autoboti i ujit dhe automjeti lavazho janë mjete që përdoren në mënyrë të integruar nga Ndërmarrja e Pastrimit, në funksion të realizimit të shërbimeve të pastrimit, larjes dhe mirëmbajtjes higjieno-sanitare të territorit dhe mjeteve të ndërmarrjes. Të dyja mjetet janë pjesë e të njëjtit proces operacional dhe shërbejnë për përmbushjen e të njëjtit funksion publik.

Mosndarja në lote:

- garanton koordinim dhe administrim më efikas të kontratës;
- siguron unifikim të përgjegjësisë për furnizimin, garancinë dhe shërbimin;
- shmang problematikat që mund të lindin nga realizimi i kontratave të ndara;
- ul kostot administrative dhe kohën e procedurave;
- mundëson vënien në funksion në mënyrë të njëkohshme të mjeteve të nevojshme për ndërmarrjen.

Ndarja në lote nuk sjell përfitim ekonomik apo teknik për Autoritetin Kontraktor, ndërkohë që mund të krijojë vështirësi në koordinimin dhe realizimin e objektit të prokurimit.

Për sa më sipër, mosndarja në lote vlerësohet në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe me parimet e eficiencës, efektivitetit dhe mirëadministrimit të fondeve publike.